

AKT THEMELIMI DHE STATUT: "SKYTECH PHONE" SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" SKYTECH PHONE " SHPK



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " SKYTECH PHONE " SHPK

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " SKYTECH PHONE " SHPK**

STATUT

**PER KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK, SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR: "SKYTECH PHONE" SHPK**

Sot më datë 08/08/2023, unë shtetasi si më poshtë, vijon:

z.ERJON SHPENDI, Shtetas Shqiptar, atësia Lulëzim lindur më 01.11.1978, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës I Pasaportës me numër passaporte : BJ8386919 dhe nr personal : H81101043I , madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Në mbështetje të dispozitave ligjore të Kodit Civil në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, vendosa themelimin e Shoqërisë Tregtare "SKYTECH PHONE" SH.P.K., shoqëri private e së drejtës Shqiptare, krijimi, funksionimi I së cilës përcaktohet si më poshtë vijon:

**KREU
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1
EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërise me pergjegjësi së kufizuar është "**SKYTECH PHONE**" SH.P.K. (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), person juridik privat I së drejtës Shqiptare, I themeluar dhe do të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri në llojin e saj është Shoqëri me Përgjegjësi të kufizuara.
- 1.2 Veprimitaria dhe funksionimi I kësaj Shoqërie rregullohet sipas neneve të statutit të kësaj shoqërie dhe në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 2
SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresën: TIRANE Rruga "Muhamet Gjollesha", Zona Kadastrale 8270, Nr. Pasurie 6/23+11-63. Kati 0.
- 2.2 Asambleja e Pergjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqerise mund te themeloje ose mbyllë dege dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda apo jashtë Republikës se Shqiperise.

**NENI 3
VULA E SHOQERISE**

- 3.1 Shoqëria ka vulën e saj, do të jetë si vijon: "**SKYTECH PHONE**" sh.p.k.

Faqe 7 nga 8



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " SKYTECH PHONE " SHPK

- 3.2 Të gjitha Aktet dhe dokumentat që do të nxjerrë Shoqëria drejtuar palëve të treta dhe publikut duhet të tregojnë qartë dhe të lexueshmë emërtimin (llojin) e Shoqërise dhe pas emrit do të jenë fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuara" ose shkurtimi sh.p.k. "SKYTECH PHONE" sh.p.k.
- 3.3 Shoqëria ka adresën e saj elektronike: e_shpendi@hotmail.com
- 3.4 Shoqëria ka nr. Kontakt të saj: **+355 67 200 0070**

NENI 4 OBJEKTI I SHOQERISE

- a. Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
- b. Ofrimin e shërbimeve, mirëmbajtjes dhe shitjes së paisjeve elektronike, celularë tableta dhe kompjuterë. Aksesorë të ndryshëm si kasa për celularë, mbrojtës ekran, kufje bateri etj.

NENI 5 KOHEZGJATJA E SHOQERISE

- 5.1 Shoqëria do të zhvillojë Veprimtarinë e saj për një kohë pa afat.
- 5.2 Ajo mund të shpërndahet para afatit me vendim të Ortakut, ose per shperndarjen e saj e percakton vetë legjislacioni ne fuqi.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 6 KAPITALI I SHOQERISE

- 6.1 Kapitali i Shoqërisë ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin dhënë nga cdo ortak në Shoqëri. Cdo Ortak zoteron një kuotë të vetme në Shoqëri. Bashkëzotërueshit e një kuote, sipas nenit 72, të këtij ligji, gëzojnë cilësinë si një ortak I vetëm.
- 6.2 Kapitali Fillestar do të jetë 100'000 lekë (Njëqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesit ne Kapitalin e Shoqërise ështe në përputhje me kontributet e tij si më poshte:

1. Ortaku I Vetëm Themelues **z. ERJON SHPENDI, mbajtës I Pasaportës me numër passaporte : BJ8386919 dhe nr personal : H81101043I.**

Zotërueshit 1 kuote të vetme me vlerën totale nominale: 100 000 lekë (Njëqind mijë lekë).

Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku që zoteron, 100 % (njëqind per qind) të kontributeve në kapitalin e shoqerisë.

Faqe 7 nga 8



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " SKYTECH PHONE " SHPK

6.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejte me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 7

KALIMI I KUOTAVE ME TRASHEGIMI OSE SI PASOJE E FALIMENTIMIT

- 7.1 Ne rast se një ortak apo një bashkezoterues i një kuote humb jeten, trashegimtaret e tij do te jene te vetmet persona qe do ti njihet titulli mbi kuoten nga Shoqeria por asnjë nga keto parashikime nuk liron perjegjesite e trashegimtareve nga cdo detyrim i mbartur nga kuota e zotruara. Ne rastin e vazhdimit te Shoqerise me disa trashegimtare te ortakut qe ka humbur jeten, trashegimtaret duhet te caktojne një perfaqesues te perbashket.
- 7.2 Personi qe fiton te drejten mbi një kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zoterues i kuotes ose te kerkonte regjistrimin e kuotes ne emer te një personi tjeter te caktuar prej tij si perfittues i kuotes . Nese personi i mesiperm zgjedh te behet zoterues i kuotes, ai njofton Shoqerine ne lidhje me kete zgjedhje. Nese personi i mesiperm zgjedh te kerkonte regjistrimin e kuotes ne emer te një personi tjeter atehere ai duhet ta kryeje ate nepermjet një akti te vlefshem te transferimit te kuotes.
- 7.3 Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote si pasoje e humbjes se jetes ose falimentimit te një ortaku do te kete te drejtat qe gezonte zoteruesi i kuotes, duke perjashtuar te drejten e pjesëmarrjes ose te votes ne mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne regjistrin tregtar si zoterues i kuotes.

NENI 8

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblese se Pergjithshme per zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakeve qe jane thirrur por nuk ishin te pranishem ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme qe vendosi per zmadhimin e kapitalit.
- 8.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithe ortaket do te kene te drejten te nenshkruajne zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne perpjasetim te drejte me kuotat qe zoterojne ne Shoqeri.
- 8.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nenshkrimit te pjeses se tyre, kapitali i panenshkruar mund te nenshkruhet nga ortaket e tjere . Ne kete rast, keta ortake mund te ushtrojne serish te drejten per nenshkrimin e kapitalit, ne perpjasetim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqeri.

NENI 9

ZVOGELIMI KAPITALIT

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e Shoqerise, me kuorumin e percaktuar ne nenin 9.12 te ketij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne cdo rast, kapitali i



AKT THEMELIMI DHE STATUT: " SKYTECH PHONE " SHPK

Shoqerise nuk mund te zvogelohet nen kufirin e peraktuar me ligj.

9.2 Ortaket e perballojne zvogelinmin e kapitalit te Shoqerise, ne perpjeshetim te drejte me pjesemarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqerise.

KREU III

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME NENI 10 ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërise. Asambleja e Pergjithshme vendos mbi te gjitha cështjet për të cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi ne Republikën e Shqipërise, sipas ketij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose do marrëveshje midis ortakëve të Shoqërissë.

10.2 Cdo ortak ka te drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehe vullnetin e tij si dhe te votojë në përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zoteron ne Shoqëri.

10.3 Cdo ortak mund te perfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një perfaquesues i deleguar me shkrim.

10.4 Ortaku nuk mund të delegojë te drejtën e votes per një pjesë te kuotave te tij te kapitalit, nese ai voton personalisht per pjesën e mbetur.

10.5 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brënda ose jashtë territorit te Republikës së Shqipërisë. Ortakët ose përfaqesuesit e autorizuar mund te marrin pjesë ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nepermjet mjeteve elektronike, perfshire telekonferencen (*conference call*) audio ose video, ne perputhje me legjisacionin per shoqerite tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme dote quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nenshkuhet procesverbali perkates.

10.6 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratori/et ose nga ortakët që përfaqesojne te pakten 5% te kapitalit te Shoqerise. Thirja e mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme duhet te behët nëpermjet njoftimit me shkrim ose me mjete elektronike, derguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqerise, te pakten 15 (pesembedhjete) dite perpara dates se caktuar per mbledhjen e saj. Njoftimi duhet te permbate rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes.

10.7 Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet rregullisht, pavaresisht nga keto formalitet, ne rast se te gjithe ortaket apo perfaquesuesit e tyre jane te pranishem dhe bien dakord per rendin e dites.

10.8 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Pergjithshme cakton një sekretar per do mbledhje midis personave te pranishem.

10.9 Vendimet e Asamblese së Përgjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kerkese te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo verejtjet e tyre.

10.10 Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten një here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.

10.11 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqesuesit e

AKT THEMELIMI DHE STATUT: " SKYTECH PHONE " SHPK

tyre, qe zotërojne me shumë se 30% (tridhjetë per qind) te kapitalit të Shoqërisë, perve rasteve te parashikuara me poshtë në nenin 9.12. Ne rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje te dyte brënda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.

10.12 Asambleja e Përgjithshme vendsos me votat pro te $\frac{3}{4}$ te ortakeve pjesëmarrës apo të përfaqesuar qe zotërojne me shume se 50% të kapitalit te Shoqërise për ndryshimin e ketij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te Shoqërise, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

11.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhe prej 5 (pese) vjetësh. Administratori mund te rizgjidhet dhe shkarkohet në cdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

11.2 Administratori zoteron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, pervec; atyre qe ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese se Përgjithshme apo organeve te tjera te Shoqerise.

11.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori eshte pergjegjes per veprimet e kryera ne administrimin e Shoqerise. Administratori mund te delegoje persona te trete per kryerjen e veprimeve dhe akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise, duke mbajtur pergjegjesi per te gjitha veprimet e kryera nga te tretet e deleguar per administrimin e Shoqerise.

11.4 Administratori do te veproje ne cdo kohe vetem ne interesin me te mire te Shoqerise. Ne rast konflikti interes, Administratori do te njoftoje menjehere ortaket si dhe do te heq dorë nga cdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

11.5 Administratori i parë i Shoqërisë do të jetë :

- ♦ z. ERJON SHPENDI, mbajtës I Pasaportës me numër passaporte : BJ8386919 dhe nr personal : H81101043I.

NENI 12 SHPERBLIMI I ADMINISTRATORIT

12.1 Asambleja e Përgjithshme percakton shperblimin e Administratorit të Shoqërisë.

NENI 13 PERFUNDIMI I DETYRES SE ADMINISTRATORIT

13.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

Faqe 7 nga 8

AKT THEMELIMI DHE STATUT: " SKYTECH PHONE " SHPK

- (a) i përfundon mandati;
- (b) shkarkohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (c) jep doreheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqerine;
- (d) personi nuk gezon cilesine e Administratorit sipas parashikimeve te ligjit;
- (e) mungon pa arsy ne detyre per me shume se 6 (gjashte) muaj radhazi dhe Asambleja e Pergjithshme vendos ta shkarkoje nga detyra.

KREU V KONTROLLI FINANCIAR I SHOQERISE, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI

NENI 14 KONTROLLI FINANCIAR

14.1 Kontrolli financiar i Shoqërise kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet ne bazë të ligjit.

NENI 15 VITI FINANCIAR

15.1 Viti Financiar i Shoqerise fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

NENI 16 BILANCI VJETOR

- 16.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme reportin mbi administrimin e Shoqerise si edhe llogarite vjetore.
- 16.2 Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 17 DIVIDENDI

17.1 Pasi te janë përbushur kërkeshat e përcaktuara nga Ligji per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqeria, me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese Pergjithshme, mund te vendose shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

17.2 Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkengjiten kuotave, te gjithe dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen sipas shumave te paguara ne

AKT THEMELIMI DHE STATUT: " SKYTECH PHONE " SHPK

kuotat ne te cilat paguhet dividendi. Te gjitha dividendet do te shperndahen dhe paguhen ne menyre proporcionale me shumat e paguara mbi kuotat gjate do pjesë ose pjeseve te periudhes ne te cilen paguhet dividendi.



AKT THEMELIMI DHE STATUT " SKYTECH PHONE " SHPK

**KREU VI
PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM,
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

**NENI 18
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

18.1 Ne rastin e prishjes dhe likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

**NENI 19
LIGJI I ZBATUESHEM**

19.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plate me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjisacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

**NENI 20
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

20.1 Mos marrëveshhjet që mund të lindin ndërmjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet ortakeve dhe trashegimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndermjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tiranë do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nenshkruehet ne 3 (tre) kopje ne gjuhen shqipe:

**ORTAKU VETEM I SHOQERISE:
“SKYTECH PHONE”
ERJON SHPENDI**

Erjon Shpendi
Shpendi